



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE ISJP-A

Nr. 1293/2 Prot.

Tiranë, më 10.10.2024

URDHËR

Nr. 40, Datë 10.10.2024

PËR

**PROCEDURËN E KONKURRIMIT DHE PËRZGJEDHJEN E PERSONELIT  
AKADEMIK ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË  
TË PJESSHME, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE,  
PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025**

Në zbatim të nenit 3, pika 4, gërma “ç”, nenit 39, pika 12, nenit 57, pika 2, nenit 59 dhe nenit 62 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 6, datë 09.10.2024 “Për propozimin për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personelin akademik të ftuar (me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme) në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2024-2025”, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 9, datë 09.10.2024 “Për propozimin për miratimin e numrit të personelit akademik të ftuar (me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme) në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2024-2025”,

**URDHËROJ:**

1. Njësitë bazë në fakultetet e Universitetit të Arteve kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë personel akademik për veprimtari të mësimdhënies, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme.
2. Njësitë bazë në fakultetet e Universitetit të Arteve përcaktojnë kriteret specifike dhe të veçanta të punësimit të personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme.
3. Për zgjedhjen e personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme ngrihen komisione *ad hoc*, në fakultetet e UART, duke iu përmbajtur rregullave të përgjithshme, si më poshtë vijon:
  - a. Shpallja e vendeve të lira, sipas kërkesave të fakulteteve të Universitetit të Arteve, bëhet nga Rektorati i Universitetit të Arteve;





- b. Njoftimi i shpalljes së vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A;
- c. Komisionet *ad hoc* pranë fakulteteve, ngrihen me urdhër nga dekani i fakultetit;
- d. Komisioni *ad hoc*, si rregull, përbëhet nga pesë anëtarë të cilët janë:
- Zëvendësrektori për anën mësimore Anëtar (dërguar nga Rektorati);
  - Drejtoria e MBNJIS/P-A Anëtar (dërguar nga Rektorati);
  - Drejtuesi i njësisë kryesore Kryetar;
  - Drejtuesi i njësisë bazë Anëtar;
  - Një anëtar nga personeli akademik me dije në fushën për të cilin zhvillohet konkursi, përcaktuar nga përgjegjësi i njësisë bazë, miratuar nga dekani.
4. Komisioni *ad hoc* organizon, drejton dhe mbikëqyr procedurat e zhvillimit të konkurrimit, shqyrton dosjet dhe vlerëson me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për secilin specialitet, të publikuara dhe të shpallura publikisht nga Rektorati i UART;
- Kryetari dhe anëtarët e komisionit *ad hoc* janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit, duke filluar që nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidatëve, zhvillimi i konkurrimit e deri në shpalljen e vendimit për vlerësimin, renditjen dhe përzgjedhjen e kandidatëve.
5. Komisioni *ad hoc*, duhet të përfundojë procedurën e konkurrimit përcaktuar në urdhër brenda dy javëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhëri.
6. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A ndihmon komisionin *ad hoc*, mbikqyr dhe kontrollon zhvillimin e procedurave të konkurrimit në përputhje me aktet e zbatueshme, si dhe njofton periodikisht rektorin për ecurinë e tyre. Në rastet kur vërehen shkelje, kjo drejtori njofton menjëherë rektorin, i cili mund të vendosë pezullimin e procedurave. Në përfundim të konkurrimit DMBNJISJ/P-A i paraqet rektorit një raport me shkrim mbi zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
7. Çdo anëtar i komisionit *ad hoc* është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë individuale të gjitha dosjet e prezantuara për konkurrim. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidatëve, komisioni *ad hoc* merr vendim për kualifikimin ose jo të kandidatëve, duke bërë renditjen e përgjithshme të kandidatëve, mbi bazën e pikëve të fituara.
8. Vendimet e komisionit *ad hoc* merren me shumicë votash. Anëtarët nuk lejohet të abstenojnë.
9. Në përfundim të procesit, kryetari i komisionit përpilon procesverbalin dhe i paraqet rektorit listën e kandidatëve sipas renditjes me pikë.
10. Rektori, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga komisioni *ad hoc*, merr vendim dhe shpall fituesit.
11. Lista e kandidatëve fitues afishohet në ambientet e Universitetit të Arteve dhe në faqen e WEB.



12. Brenda 5 ditëve nga shpallja e kësaj liste, kandidatët konkurrentë mund të ankohen pranë rektorit për renditjen e pikëve të shpallura nga komisioni *ad hoc*. Në këtë rast, si dhe në rastet kur rektori e çmon të nevojshme verifikimin e procedurave të konkurrimit, dekani i fakultetit i paraqet rektorit dosjen e plotë të konkursit.
13. Në rastet e përcaktuara më lart, rektori shqyrton dosjen e konkurrimit dhe vendos sipas rastit:
  - a. Të mos pranojë ankimin;
  - b. Të kthejë dosjen e konkursit për rivlerësim;
  - c. Të anulojë konkursin.
14. Pas shpalljes së vendimit, mbështetur në ligjin nr. 80/2015 dhe në Kodin e Punës, kandidatët lidhin kontratë pune me Universitetin e Arteve. Kontrata nënshkruhet nga punëmarrësi dhe punëdhënësi (rektori).
15. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësrektori për anën mësimore, dekanët dhe drejtuesit e njësive bazë në fakultete si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1293/1 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

VENDIM

Nr. 6, datë 09.10.2024

PËR

**PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR PERSONELIN AKADEMIK TË FTUAR (ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME) NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “ç” si dhe në nenin 38 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 24 të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresën nr. 1293 prot., datë 04.10.2024 me lëndë “Dërgohen për miratim kriteret e vlerësimit të personelit akademik të ftuar”, pasi e shqyrtoi dhe diskutoi mbi materialin e përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Propozimin për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personelin akademik të ftuar (me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe angazhim me kohë të pjesshme) në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2024-2025, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim t’i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)

PROF. ASOC. KRISTINA LAÇO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK  
KRYETARI

Nr. 1293 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

**Lënda:** Dërgohen për miratim kriteret e vlerësimit të personelit akademik të fuar

SENATIT AKADEMIK,  
UNIVERSITETI I ARTEVE

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, gërma ç si dhe në nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur dërgohet për miratim materiali i përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore JSIP-A, mbi kriteret e vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, në Universitetin e Arteve, miratuar paraprakisht nga 3 (tre) Drejtuesit e Njësive Kryesore të Universitetit të Arteve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE JSIP-A

## LIDHJA I


### KRITERET E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR PERSONEL AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHË TË

### CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE"

#### I. Kriteret bazë për dosjet e konkurrentëve:

Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar në UAR bëhet përmes konkurrimit me dosje, sipas kërkesave të fakulteteve të Universitetit të Arteve si dhe mbështetur në VKM Nr. 331, datë 25.3.2009 "Për ndarjen në nivele, brenda kategorive, të personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë, emërtimin e renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune".

1. Dosja e kandidatit për personel akademik i ftuar duhet të përmbajë Jetëshkrimin (CV) me të dhënat e shoqëruara me dokumentacion:
  - 1.1 Të dhëna të noterizuara të arsimit të kandidatit;
  - 1.2 Të dhëna të noterizuara të kualifikimeve pasuniversitare të kandidatit, Tituj dhe Grada Shkencore; Të dhëna për biografinë artistike dhe/ose shkencore të kandidatit duke filluar nga periudha e pas studimeve;
  - 1.3 Të dhëna për përvojën pedagogjike të kandidatit pranë IAL-ve;
  - 1.4 Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar;
  - 1.5 Dëshminë/vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
  - 1.6 Dëshminë mjeko ligjore;
2. Të dhënat e legalizuara të kualifikimeve pasuniversitare të kandidatit do të vlerësohen vetëm nëse, janë në specialitetin e kërkuar apo programin e studimit në të cilin konkurron.
3. Konkurrentët të jenë diplomuar në ciklin 4-vjeçar të studimeve ose të jenë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve Master;
  - 3.1 Të jenë diplomuar në Specialitetin dhe fushën përkatëse në sistemin me kohë të plotë brenda ose jashtë vendit, sipas kërkesave të Njësisë Bazë. Për lëndët që nuk janë të fushës së artit, preferenca dytësore në lidhje me diplomimin e tyre;
  - 3.2 Kandidati/tja, e diplomuar jashtë vendit, duhet detyrimisht ta kenë të njehsuar diplomën në MASR;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Konkurrentët që janë mbajtës të titullit akademik **“Profesor”** apo **“Profesor i Asociuar”** dhe që janë bashkëpunëtorë në kohështrirje me fakultet e Universitetit të Arteve, me **propozim** të Përgjegjësit të Departamentit dhe me **vendim** të Dekanit të Fakultetit kanë përparësi. Për këto personalitete mjafton vetëm një kërkesë dhe fotokopje e dokumentit të titullit;
5. Për personalitete të fushës të artit (sipas nenit 62 të ligjit 80/2015) që ofrohen të japin mësim në Universitetin e Arteve, nuk merret në shqyrtim dosja e tyre. Në këto raste Dekani i fakultetit shprehet me një Vendim të posaçëm për to;
6. Të gjithë konkurrentët të cilët nuk kanë Titull akademik apo gradë shkencore duhet ta kenë **notën mesatare të shkollës së lartë mbi 8**;
7. Për kandidatët që nuk kanë vite pune në mësimdhënie, Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani, duhet të shprehen me një vendim të veçantë për to, për arsyet e marrjes në mësimdhënie (**është kriter punësimi 3 vite ne IAL**);
8. Në veprimtarinë pedagogjike të Kandidatit në periudhën e pas studimeve do të vlerësohet me përparësi përvoja pedagogjike pranë IAL-ve dhe më parësore ajo në Universitetin e Arteve, si dhe rezultatet e bashkëpunimit ndër vite duke i dhënë prioritet Vlerësimit Vjetor të Përgjegjësve të Njësive Bazë.
9. Personeli akademik i cili ka Vlerësim negativ (në një nga pikat vlerësuese të punës së një punonjësi mësimorë) nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë ku ai është i punësuar, atëherë punonjësi akademik nuk do të lejohet të rinovojë dokumentacionin për vijim punësimi.

## II. Kriteret e përgjithshme: Gjithsej 50 pikë

### 1. Kualifikime dhe aktiviteti shkencor.

- Doktor brenda vendit **10 pikë**
- Doktor jashtë vendit **15 pikë**
- Tekst mësimor i botuar. **5 pikë**
- Artikull/artikuj shkencorë të botuara brenda vendit, **5 pikë**
- Artikull/artikuj shkencorë botuar jashtë vendit, **5 pikë**

### 2. Përvojë pune në mësimdhënie në profesionin e kërkuar.

- Çdo 1 vit pune në mësimdhënie në specialitetin për të cilin konkurron vlerësohet me 1 pikë. Maksimalja e pikëve për këtë vlerësim është **10 pikë**.

## III. Kriteret artistike dhe profesionale: Gjithsej 50 pikë

### 1. Interpretime dhe vepra artistike etj.

- Aktivitete artistike individuale **15 pikë**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Vepra të vëna në skena prestigjioze, koncerte solistike, ekspozita individuale, etj. **15 pikë**
- Pjesëmarrje kolektive në aktivitete artistike brenda vendit **10 pikë**
- Pjesëmarrje kolektive në aktivitete artistike jashtë vendit **10 pikë**


**V.O.**

**Dosja e secilit prej konkurrentëve për personel akademik me kontratë të caktuar dhe me kohë të pjesshme, do të vlerësohet në maksimalen e saj me 100 pikë.**

**Këto kritere hyjnë në fuqi për konkurset që do të zhvillohen për personel akademik me kontratë të caktuar dhe me kohë të pjesshme, me miratimin në *Senatin Akademik***

**“PËR MODALITETIN E PRANIMIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHË TË CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

1. Bazuar në shtimin e numrit të punonjësve efektivë, (sipas kërkesave të fakulteteve të UART), të kufizohet numri i punonjësve akademikë me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme;
2. Asnjë person nuk do të marrë pjesë në procesin mësimor pa u miratuar si punonjës akademikë me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme;
3. Asnjë nga kandidaturat e përzgjedhura nga konkursi nuk do të miratohet nëse brenda afatit të caktuar, nuk do të paraqesë në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dokumentacionin ku përveç kritereve të konkurrimit kërkohet:
  - a. të vërtetojë përvojën akademike;
  - b. të vërtetojë pajtueshmërinë e përvojës akademike në fushën në të cilën do të ushtrojë veprimtarinë akademike;
  - c. të paraqesë 2(dy) rekomandime nga profesorë të institucioneve akademike nga vijnë;





REPUBLIKA E SHQIPËRISE


- d. të vërtetojë që lejohen nga qendra e punës, për t'u angazhuar punonjës akademikë me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, në institucionin tonë;
- e. të nënshkruaj kontratën e punës për atë periudhë që lejohet të angazhohet në institucionin tonë.
4. Punonjësi akademikë me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, pas miratimit, në raport me kohën që janë të angazhuar në UART do t'u nënshtrohen të gjitha rregullave disiplinore, pasi kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë edhe pedagogët efektivë;
5. Trajtimi financiar i punonjësve më lart do të bëhet pasi të kenë plotësuar modalitetet e pranimit të tyre;
6. Të mos planifikohet asnjë punonjës efektiv i administratës/akademik së UART, si punonjës akademikë me kontratë me kohë të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme.
7. Për zbatimin e kriterëve ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Burimeve Njerëzore, Dekanët dhe Përgjegjësit e Njësive Bazë pranë fakulteteve të UART.

Dr. MBNJ

*Elia Plaku*  
Msc. Elia PLAKU

*Mirafollet*  
dekan i F.A.B  
Prof. Sadik Spasija

*Mirafollet*  
Dekani i F.A.S  
Prof. Mirafollet  
Mirafollet  
Zv. Dekan  
Silvana Stevanli  
Steno



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1261 Prot.

Tiranë, më 09.10.2024

VENDIM

Nr. 9, datë 09.10.2024

PËR

**PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR (ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME) NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “ç” si dhe në nenin 38 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 24 të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresat e Fakultetit të Artit Skenik me nr. 1189 prot., datë 19.09.2024, të Fakultetit të Muzikës me nr. 1227 prot., datë 25.09.2024 dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 1202 prot. datë 23.09.2024, në lidhje me parashikimet për pedagogë të ftuar për vitin akademik 2024-2025, si dhe pasi shqyrtoi e diskutoi Relacionin nr. 1261 prot., datë 30.09.2024 të Drejtorit të DMBNJ dhe të Zv.Rektorit për anën mësimore, me votim të hapur,

VENDOSI:

- Propozimin për miratimin e numrit total prej 125 anëtarësh të personelit akademik të ftuar për vitin akademik 2024-2025, në Fakultetet e UART (ndarë në departamente), sipas shkresave bashkëlidhur këtij vendimi:
  - Fakulteti i Muzikës, në total 69;
  - Fakulteti i Arteve të Bukura, në total 22 ;
  - Fakulteti i Artit Skenik, në total 34 .
- Ky vendim t’i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
- Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe të Transparencës.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI



Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI



Prof. Miltiadh KUTALI



Prof. Sadik SPAHIJA



Prof. Lorenc RADOVANI



Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA



Prof. Rudina CIKO



Prof. Gazmend GJOKA



Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA



Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI




Prof. Asoc. Genci FUGA



Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima



Enea TRIMI (Student FAB)



Rei KITA (Student FM)



PROF. ASOC. KRISTINA LACO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE & I P-A

## REKTORATI

**I UNIVERSITETIT TË ARTEVE SHPALL KONKURSIN PËR  
PERSONEL AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË  
CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME  
(PEDAGOG I JASHTËM), PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025.**

**DOKUMENTACIONI PËRKATËS DO TË DORËZOHET PRANË  
DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE  
ISJ/P-A:**

**- NGA DATA 11.10.2024 DERI MË 20.10.2024.**

**ORARI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT NGA E  
HËNA NË TË PREMTE ËSHTË 08:00 – 16:00, NDËRSA  
DITËN E SHTUNË DHE TË DIEL, NGA ORA 09:00 –  
14:00.**

**BASHKËNGJITUR GJENDET DOKUMENTACIONE PËRKATËS  
SIPAS VENDIMEVE TË SENATIT AKADEMIK**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE & I P-A

**ANËTARËT E PERSONELIT AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, TË CILËT KANË QENË TË PUNËSUAR NË VITIN PARAARDHËS AKADEMIK DHE KANË DOSJEN E PUNËS NË DREJTORINË E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, DO TË DORËZOJNË VETËM KËTO DOKUMENTA:**

- **KËRKESËN PËR POZICIONIN E PUNËS;**
- **CV (të rinovuar);**
- **LEJE DHE VLERËSIM (pune) NGA PUNËDHËNËSI I FUNDIT (ku punon aktualisht/vetëdeklarim si i papunë);**
- **DËSHMI GJYQËSORE/VETËDEKLARIM;**
- **RAPORT MJEKO-LIGJOR;**
- **VËRTETIM VJETËRSIE NË PUNË (në arsimin e lartë);**



**SKEDË APLIKIMI**  
**PËR PUNONJËS AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE**  
**ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË FAKULTETIN E MUZIKËS,**  
**PRANË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

POZICIONI I PUNËS KU APLIKON \_\_\_\_\_

1. Emri: \_\_\_\_\_ Atësia: \_\_\_\_\_ Mbiemri: \_\_\_\_\_;
2. Datëlindja (dd/mm/vvvv): \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_;
3. Gjinia:  Femër  Mashkull
4. Kërkesa për pozicionin e punës për të cilin konkurron: (shoqëron skedën)
5. Universiteti që ka përfunduar \_\_\_\_\_;
6. Programi i studimit që ka përfunduar: \_\_\_\_\_;
7. Nota mesatare e viteve të studimit \_\_\_\_\_;
8. Mbrojtja e gjuhës së huaj:  Dëshmi  Çertifikatë
9. Vërtetim gjyqësor:  Dëshmi  Vetëdeklarim
10. Raporti mjekësor: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
11. Specialiteti për të cilën aplikon: \_\_\_\_\_;
12. Numër celulari: \_\_\_\_\_;
13. Adresë e-maili: \_\_\_\_\_;
14. Numri ID: \_\_\_\_\_; Nr. llogarisë bankare: \_\_\_\_\_/Banka: \_\_\_\_\_;
15. Referencë nga punëdhënësi i fundit/institucioni: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
16. Vërtetim nga punëdhënësi aktual që lejon mësimdhënien në UART: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
17. Çertifikatë familjare/ID \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
18. Vërtetim vjetërsie në punë/fotokopje e librezës së punës \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);

**MARRËSI NË DORËZIM**  
**ZNJ. ELIA PLAKU/ADEMI**

**APLIKUESI**

**DREJTOR**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE ISJ/P-A**

**Emër, Atësi, Mbiemër**  
**Firma**

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024



**SKEDË APLIKIMI**  
**PËR PUNONJËS AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE**  
**ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA,**  
**PRANË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

POZICIONI I PUNËS KU APLIKON \_\_\_\_\_

1. Emri: \_\_\_\_\_ Atësia: \_\_\_\_\_ Mbiemri: \_\_\_\_\_;
2. Datëlindja (dd/mm/vvvv): \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_;
3. Gjinia:  Femër  Mashkull
4. Kërkesa për pozicionin e punës për të cilin konkurren: (shoqëron skedën)
5. Universiteti që ka përfunduar \_\_\_\_\_;
6. Programi i studimit që ka përfunduar: \_\_\_\_\_;
7. Nota mesatare e viteve të studimit \_\_\_\_\_;
8. Mbrojtja e gjuhës së huaj:  Dëshmi  Çertifikatë
9. Vërtetim gjyqësor:  Dëshmi  Vetëdeklarim
10. Raporti mjekësor: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
11. Specialiteti për të cilën aplikon: \_\_\_\_\_;
12. Numër celulari: \_\_\_\_\_;
13. Adresë e-maili: \_\_\_\_\_;
14. Numri ID: \_\_\_\_\_; Nr. llogarisë bankare: \_\_\_\_\_/Banka: \_\_\_\_\_;
15. Referencë nga punëdhënësi i fundit/institucioni: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
16. Vërtetim nga punëdhënësi aktual që lejon mësimdhënien në UART: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
17. Çertifikatë familjare/ID \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
18. Vërtetim vjetërsie në punë/fotokopje e librezës së punës \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);

**MARRËSI NË DORËZIM**  
**ZNJ. ELIA PLAKU/ADEMI**

**APLIKUESI**

\_\_\_\_\_  
**DREJTOR**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE ISJ/P-A**

\_\_\_\_\_  
**Emër, Atësi, Mbiemër**  
Firma

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024





**SKEDË APLIKIMI**  
**PËR PUNONJËS AKADEMIK ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE**  
**ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME, NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,**  
**PRANË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

POZICIONI I PUNËS KU APLIKON \_\_\_\_\_

1. Emri: \_\_\_\_\_ Atësia: \_\_\_\_\_ Mbiemri: \_\_\_\_\_;
2. Datëlindja (dd/mm/vvvv): \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_;
3. Gjinia:  Femër  Mashkull
4. Kërkesa për pozicionin e punës për të cilin konkurron: (shoqëron skedën)
5. Universiteti që ka përfunduar \_\_\_\_\_;
6. Programi i studimit që ka përfunduar: \_\_\_\_\_;
7. Nota mesatare e viteve të studimit \_\_\_\_\_;
8. Mbrojtja e gjuhës së huaj:  Dëshmi  Çertifikatë
9. Vërtetim gjyqësor:  Dëshmi  Vetëdeklarim
10. Raporti mjekësor: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
11. Specialiteti për të cilën aplikon: \_\_\_\_\_;
12. Numër celulari: \_\_\_\_\_;
13. Adresë e-maili: \_\_\_\_\_;
14. Numri ID: \_\_\_\_\_; Nr. llogarisë bankare: \_\_\_\_\_/Banka: \_\_\_\_\_;
15. Referencë nga punëdhënësi i fundit/institucioni: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
16. Vërtetim nga punëdhënësi aktual që lejon mësimdhënien në UART: \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
17. Çertifikatë familjare/ID \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);
18. Vërtetim vjetërsie në punë/fotokopje e librezës së punës \_\_\_\_\_ (shoqëron skedën);

**MARRËSI NË DORËZIM**

**ZNJ. ELIA PLAKU/ADEMI**

**DREJTOR**

**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE ISJ/P-A**

**APLIKUESI**

**Emër, Atësi, Mbiemër**

**Firma**

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024



# FORMULAR VETËDEKLARIMI

TË DHËNAT E VETËDEKLARUESIT:

EMRI, MBIEMRI	
ATËSIA, AMËSIA	
DATËLINDJA	
VENDLINDJA	
DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT (kopje bashkëlidhur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam...

i/e padënuar  i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I DEKLARIMIT

\_\_\_\_\_  
emër/ mbiemër/ firmë

\_\_\_\_\_  
emër/ mbiemër/ firmë/vulë

**AUTORIZIM :** Deklaroj se të dhënat në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga UNIVERSITETI I ARTEVE (Autoriteti përgjegjës: Znj. Elia PLAKU/ADEMI)

Subjekti i autorizuar

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024  
Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi, do të bëhen vetëm në përputhje me Ligjin «Për mbrojtjen e të dhënave personale», i ndryshuar.

Deklarimi i rremë ngarkon me përgjegjësi penale sipas ligjit dhe sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

